



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. __ date __. __. 2026.

**MBI KËRKESËN PËR MIRATIMIN PËR “AUTORIZIMIN E BASHKISË
GJIROKASTËR PËR FILLIM E PROCEDURAVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
SAJ TË ISH SHKOLLËS FILLORE “BAJO TOPULLI”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2; nenit 25; neni 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit 8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; nenit 3 të Ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësinë e Qeverisjes Vendore”, Ligji Nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar, VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për Përcaktimin e Procedurave të Hollësishe të Përditësimit të Listave të Pronave Shtetërore dhe Rregullave për Bashkëpunimin Ndërmjet Institucioneve”, të VKM nr.782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modelevetë akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për “Autorizimin e Bashkisë Gjirokastër për fillim e procedurave për kalimin në pronësi të saj të ish shkollës fillore “Bajo Topulli” me destinacion “Qendër Multifunkionale Kulturore dhe Teknologjike”, Lagje Dunavat II, Gjirokastër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, Njësia e Koordinimit të Integritetit Europian dhe Ndhmës së Huaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Bexhet Baxhella

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita Isarai